



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVA
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E DEÇANIT
MUNICIPALITY OF DEÇAN
OPSTINA DEÇAN



Drejtoria për Mbrojtje, Shpëtim dhe Shërbime Publike

09 Nr. _____ /2026

Dt. 28/01/2026

PLANI VJETOR I PUNËS NGA SEKTORI PËR SHËRBIME PUBLIKE 2026

	DALËSE - IZLAZNA - OUTGOING	
	REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA	
	KOMUNA E DEÇANIT - OPSTINA DEÇAN - DEÇAN MUNICIPALITY	
Nr. i Daliës:	Drej. Mb. Shë. Publike	2143
Drej. Mb. Shë. Publike		
Nr. i ftohtës:	09	28-01-26
Br. shpëtim:		
No. dëgjues:		
		DEÇAN DEÇANE

Drejtori për Mbrojtje, Shpëtim dhe Shërbime Publike

Izet Zenuni

Plani Vjetor i Punës për Sektorin e Shërbimeve Publike-2026



Shef i Sektorit për Shërbime Publike

Xhevat Lufaj

për:

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 03/L-040 mbi Vetëqeverisje Lokale, Ligji Nr. 08/L-260 mbi Ndarjet Buxhetore, planifikimin e buxhetit vjetor, objektivat e Kryetarit të Komunës, detyrat sipas organogramit të drejtorisë, si dhe kërkesave të qytetarëve të dala nga dëgjimet publike gjatë planifikimit buxhetor, Sektori për Shërbime Publike ka përgatitur planin vjetor për vitin 2026.

Drejtoria për Shërbime Publike për vitin 2026 planifikon rritjen e investimeve në infrastrukturë publike, në përmbylljen e zgjerimit të ndriçimit publik ESCO, ndërtimin e rrugëve lokale, zgjerimin e rrjeteve të kanalizimeve fekale si dhe trajtimin e tyre, mirëmbajtja e hapësirave publike si dhe investimeve tjera të nevojshme që janë prioritet për qytetarët e komunës sonë. DSHP planifikimin për punët që janë në vazhdim dhe ato që do të fillojnë do ti realizon përmes:

- Implementimit të projekteve kapitale në infrastrukturën publike, në rrugë, në efikasitet të ndriçimit publik dhe në mirëmbajtje , në zgjerim të rrjeteve të ujërave fekale dhe atmosferike, në trotuare dhe në projekte tjera në interes të qytetarëve,
- Mirëmbajtjes së rrugëve gjatë sezonës verore dhe dimërore.
- Mirëmbajtjes së hapësirave publike, parqeve, varrezave, lapidareve, si dhe projekteve tjera që janë implementuar dhe kanë nevojë për mirëmbajtje.

PLANIN VJETOR PËR VITIN 2026

Nr.	Planifikimi i Aktiviteteve	Koha	Realizuesi
1.	<p>Planifikimi i projekteve:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Zgjerimi i rrjetit të ndriçimit në Bjeshkën e Madhe faza II - Memoriali i Dëshmorëve në Bjeshkën e Belegut - Ndërtimi dhe asfaltimi i rrugës “Mehmet Uka” në Deçan - Zgjerimi dhe asfaltimi i rrugës “Elez Geci dhe Maxhun Berisha” - Zgjerimi i ndriçimit eficient nëpër fshatrat: Papiq, Maznik, Ratish i Eperm dhe Ratish i Ulët, Pemishte, Prilep dhe rrugicat e mbetura faza II - Trotuari në fshatit Prapaqan, Llukë e Epërme, Irzniq, Isniq dhe Drenoc - Ndërtimi i rreth rrotullimit dhe trotuarit në fshatin Gramaqel - Ndërtimi i kanalizimit të lagjes afër shëtitores së Lumbardhit dhe lagjeve përreth tij - Ndërtimi dhe rregullimi i rrugës dhe trotuarit në rrugën “UÇK” - Ndërtimi i objektit për nevoja të OVL-së - Ndërtimi i urave në Bjeshkën ”Zalli i Rupës” dhe” Pllaçica e Vokshit” - Mirëmbajtja e ndriçimit publik - Ndërtimi i mbishkrimeve digjitale në hyrjet e qytetit - Ndërtimi i oborrit riciklues - Kontejnerët nëntokësor - Strehimore për qentë endacak 	Gjatë Vitit	Drejtoria për Mbrojtje, Shpëtim dhe Shërbime Publike

	<p>Projektet në vazhdim për vitin 2026</p> <ul style="list-style-type: none"> - Ndërtimi, rekonstruimi dhe mirëmbajtja kapitale e rrugëve verore dhe dimërore - Zgjerimi i ndriçimit eficient publik nëpër fshatrat e mbetura deri në përfundim të tij. - Ndërtimi i rrethojave dhe rregullimi i hapësirave brenda në oborret e “Qendrës Rinore”, “Higjienës “ dhe “Kolonisë së Artistëve dhe shtëpisë Alpine” ; - Ujësjetësi në Bjeshkën e Madhe dhe bjeshkët tjera. - Vendosja dhe mirëmbajtja e tabelave informuese ,emërtimet e fshatrave, rrugëve etj 		
2.	<p>Shërbimi për grumbullimin e mbeturinave</p> <ul style="list-style-type: none"> - Shërbimi i grumbullimit të mbeturinave do të fillojë si pilot projekt në: <ul style="list-style-type: none"> • Ndarjen e mbeturinave në burim dhe riciklimi i tyre. • Mbeturinat e ngurta, do të mblidhen dhe do të deponohen, në deponinë e caktuar nga komuna si dhe do të mbrohet mjedisi nga ndotja. - Aksione për pastrimin e qytetit (me data të caktuara). - Largimi i deponive ilegale. - Fushata e vetëdijesimit me qytetarë rreth ndarjes në burim të mbeturinave, llojin e tyre . - Shënimi i datave të veçanta për ambientin dhe tokën me aktivitete të përbashkëta mes komunës së Deçanit dhe institucioneve tjera. - Monitorimi dhe përcjellja e aktiviteteve në bashkëveprim me organizata qeveritare dhe joqeveritare rreth ngritjeve të kapaciteteve në ekonominë qarkore në nivel regjioni. - Hartimi dhe dorëzimi i raportit vjetor lidhur me indikatorët e performancës në fushën e menaxhimit të mbeturinave komunale, në Agjencinë për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës (AMMK). 	Gjatë vitit	Drejtoria për Mbrojtje, Shpëtim dhe Shërbime Publike

3.	<p>Mbikëqyrja dhe menaxhimi i kontratës “Në Shtëpi”</p> <ul style="list-style-type: none"> - Kontrata “Në shtëpi” e rregullon dhe e definon mirëmbajtjen e hapësirave publike, lapidaret dhe varrezat e dëshmoreve, larjen dhe fshirjen e rrugëve dhe trotuareve në komunën e Deçanit si dhe tema tjera të specifikuara saktë në kontratë sipas anekseve. - Menaxheri do të bëjë monitorimin e kontratës, konstatimin e punëve të kryera dhe koordinimin mes Komunës dhe Kompanisë “Higjiena”. - Zyrtari i Lartë për Menaxhimin e Mbeturinave, do të koordinon aktivitetet, planifikimet, fushatat vetëdijesuese, performancën mes Komunës dhe Kompanisë “Higjiena” si dhe kompanive tjera lokale apo gjegjionale. 	Gjatë vitit	Drejtoria për Mbrojtje, Shpëtim dhe Shërbime Publike
4.	<p>Ujësjiellësi</p> <ul style="list-style-type: none"> - Mirëmbajtja e rrjetit të ujësjiellësit në bashkëpunim me kompaninë regjionale K.R.U “Hidrodrini” njësi në Deçan - Vazhdojnë punimet në projektet e nisura dhe projektet e reja për zgjerim të ujësjiellësit në bjeshkët e Deçanit. 		
5.	<p>Ujërat e zeza</p> <ul style="list-style-type: none"> - Mirëmbajtja e rrjetit të kanalizimit në bashkëpunim me kompaninë regjionale K.R.U “Hidrodrini” njësi në Deçan dhe kompaninë NPL “Higjiena”. 	Gjatë vitit	Drejtoria për Mbrojtje, Shpëtim dhe Shërbime Publike
6.	<p>Mirëmbajtja dhe zgjerimi i ndriçimit publik</p> <ul style="list-style-type: none"> - Modernizimi dhe riparimi i ndriçimit ekzistues; - Zgjerimi i ndriçimit publik eficient në fshatrat tjera të komunës së Deçanit. - Ndërrimi i ndriçimit nga ekzistues në eficient në institucione publike, shkolla etj. - Mirëmbajtja e ndriçimit publik. 	Gjatë vitit	Drejtoria për Mbrojtje, Shpëtim dhe Shërbime Publike
7.	<p>Kryerja e punëve tjera administrative dhe të pa planifikuara</p> <ul style="list-style-type: none"> - Shqyrtimin e kërkesave të ndryshme të qytetarëve drejtuar Drejtorisë së Shërbimeve Publike. - Lëshimin e pëlqimeve dhe lejeve për shfrytëzimin e hapësirave publike, tabelave reklamuese, reklamave ndriçuese, faturave sipas rregullores komunale për lartësinë e taksave, ngarkesave, tarifave dhe gjobave komunale nr. prot. 01/18619. - Konstatime, - Përcjellja dhe monitorimi i të gjitha kontratave që janë në kuadër të Drejtorisë për Mbrojtje, Shpëtim dhe Shërbime Publike nga zyrtarët e drejtorisë. - Hartimi i planit operativ për situatat emergjente për sezonin dimëror etj. 	Gjatë vitit	Drejtoria për Mbrojtje, Shpëtim dhe Shërbime Publike

Plan Vjetor - Transport Publik, Komunikacioni dhe Hapësirat Publike 2026

Nr.	Planifikimi i Aktiviteteve	Koha	Realizuesi	Bashkëpunimi
I.	<ul style="list-style-type: none"> - Bashkëpunimi me institucione lokale dhe qendrore : Policinë e Kosovës, Inspektoratin e Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Mjedisor dhe Infrastrukturës, përfaqësues të komuniteteve etj. - Koordinimi mbi aktivitetin e transportit publik të mallrave dhe udhëtarëve me kompanitë publike dhe taksitë individual. - Caktimi i linjave për bartjen e udhëtarëve në trafikun urban. - Dhënia e pëlqimit për regjistrimit e taksistëve sipas rregullores së komunikacionit. - Bashkëpunimi me Policinë e trafikut për lirim të trotuareve nga automjetet. - Përkujdesja për shënjimin vertikal dhe horizontal të rrugëve lokale. - Propozimi për mbylljen e përkohshme të rrugëve në rast nevojë (punime, festa, protesta) etj. - Caktimi i drejtimeve rrugore për qarkullimin e automjeteve në zonën urbane dhe lokacionet e limituara për parkingje. - Lëshimi i lejeve për vendosjen e pengesave në rrugë që janë kompetencë e Komunës. - Kryerja e punëve të tjera sipas ligjit dhe rregullores në fuqi, dhe kërkesave të drejtorit. - Hartimi i Draft Plani Lokal i Transportit Rrugor 2023-2027 - Pajisja e rrugëve me sinjalizim horizontal dhe vertikal - Vendosja e pengesave rrugore afër institucioneve me rëndësi të veçantë (shkolla, spitale, çerdhe etj) 	Gjatë vitit	Zyrtari	Drejtori, Shefi,